



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË**

VENDIM

Nr. 61 datë, 30/04 / 2026

MBI

MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR Z. KOSTIKA MISRASI PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA ZJARRI NË BANESËN E TIJ.

Këshilli i Bashkisë Korçë, në mbledhjen e datës së sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, "Sektori i Emergjencave Civile", bazuar në Ligjin, 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile", të nenit, 29, të Ligjit nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", VKM-së, nr. 329, datë, 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", kapitulli i III-të, pika 2, gërma ë, e Ligjit nr. 9936, datë, 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018, i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 14.1.2026, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", "VKB nr. 139, datë 26.12.2025, "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026, dhe PBA 2026-2028, të Bashkisë Korçë", VKB nr. 139, datë 26.12.2025, "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026, dhe PBA 2026-2028, të Bashkisë Korçë", i ndryshuar", si dhe urdhrin nr. 12 datë 7.1.2026, "Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2026 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë sipas programeve dhe produkteve", i ndryshuar.

VENDOSI:

1. Miratimin e ndihmës financiare z. Kostika Misrasi, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tij në vlerën 671,071,46 lekë.
2. Kjo shumë do të përballohet nga fondi i miratuar për Emergjencat Civile, në buxhetin e e vitit 2026, sipas VKB nr.139 datë 26.12.2025 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë", i ndryshuar, në programin Siguria Publike, me këtë strukturë buxhetore:
Prog. AB122 00 Prod. V091AAD 01 Art. 6060000 671,071,46 lek, (Siguria Publike)
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, , Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MKF dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Sektori i Emergjencave Civile).

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit, 55, pika 6, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miraturar me 23 vota

Vota pro 23

Vota kundër 0

Vota Absteni 0

Zbardhur më datë 30-04-2026

KRYETAR

Ana VERUSHI

